



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**PSH Nr. 02/17**

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT** i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 në përbërje prej: z. Blerim Dina – Kryetar, z.Nuhi Paçarizi- referues, z. Ekrem Salihu – anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 dhe konform nenit 39 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 02/2015, pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/, që OSHP-ja të veproj konform nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së, përkitazi me OE-së “Solid Company”-, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Riparimi mekanik dhe elektrik i stacionit veprues të shiritit transportues me gjerësi 1800mm”, me nr. të Prok: /16/164/511, më 14 mars 2017, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa e autoritetit kontraktues, (AK) - /Korporata Energjetike e Kosovës/ e dt: 06.01.2017 për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurim publik të OE “Solid Company”, për shkak të prezantimit të dokumenteve( katalogut) të falsifikuar, lidhur me aktivitetin e prokurimit, “Riparimi mekanik dhe elektrik i stacionit veprues të shiritit transportues me gjerësi 1800mm” me nr të prokurimit KEKC 16/164/511/, për shkak se nuk janë përmbush kushtet e parapara konform nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së

## ARSYETIM

Autoriteti kontraktues / Korporata Energjetike Kosovës /, me dt:06.01.2017 ka parashtruar kërkesë, në OSHP, që të vepohet konform nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së, për diskualifikim të OE "Solid Comapny"

Lidhur me kërkesën e lartpërmendur, OSHP-ja ka caktuar seancë dëgjimore me datë 14.03.2017, e cila është mbajtur konform nenit 28.1 të rregullores së OSHP-së, pa praninë e palëve të përfshira në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues i OSHP-së deklaroi: AK-KEK me datë 06.01.2017 ka deponuar në OSHP kërkesën me nr 02/17 për shqyrtim të dokumentacionit dhe marrje të masave ndaj OE "Solid Company" sipas dispozitave të LPP-së. Me datë 30.01.2017 OSHP më ka autorizuar për përgatitje të kronologjisë në lidhje me këtë rast për panelin shqyrtues. Me datë 03.02.2017 eksperti i dorëzon panelit Kronologjinë lidhur me kërkesën e AK-KEK. Ashtu siç kam potencuar edhe në kronologjinë datë 03.02.2017, pas kërkesës për rishqyrtim të OE "Eko Invest", komisioni rivlerësues i është drejtuar prodhuesit "Viva Tech" me shkresë të datës 27.12.2016 për të verifikuar autenticitetin e katalogut të prodhuar në ofertë.

Me datë 18.12.2016 prodhuesi "Viva Tech" është përgjigjur se katalogu i ofruar është origjinal i tij dhe merr përgjegjësinë për rregullsinë e katalogut, njëkohësisht deklaroi se nuk ka shkel asnjë të drejtë autoriale dhe për këtë përmban përgjegjësi të plotë ligjore dhe materiale. AK-KEK deklaroi se edhe pse është pranuar konfirmimi nga prodhuesi se katalogu është i rregullt, dyshon se katalogu i prezantuar është i adaptuar nga katalogët e prodhuesve tjerë dhe i përvetësuar.

Po ashtu komisioni i rivlerësimit ka konstatuar se asnjë ofertë nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe se ky aktivitet i prokurimit është anuluar. Publikimi i njoftimit për anulim është bërë me datë 05.01.2017 në faqe të KRPP-së.

E lus panelin shqyrtues që të shqyrtoj dokumentacionin e bashkangjitur kësaj shkrese dhe nëse konstatohet se katalogu është i falsifikuar konform dispozitave të LPP të ndërmerren masa ndaj OE "Solid Company".

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës, në kronologjinë e ekspertit të OSHP-së dhe në të gjitha faktet tjera, vjen në përfundim se autoritetit kontraktues ka shpreh dyshime lidhur me katalogun e ofruar nga kompania Solid e cila e ka ofruar katalogun nga prodhuesi "Viva Tech"-Serbi, mirëpo në lidhje me këto dyshime nuk ka ofruar asnjë provë dhe asnjë fakt se katalogu në fjalë është i falsifikuar dhe me këtë rast nuk janë përmbush kushtet e nenit 99 paragrafi 2 të LPP-së, që operatori ekonomik Solid Company të diskualifikohet nga pjesëmarrja në prokurim publik.

Paneli shqyrtues me rastin e vendosjes ka pasur parasysh edhe përgjigjen e AK-së të dt:23.01.2017, drejtuar OSHP-së, e ku në atë përgjigje AK-ja sqaron se kanë kërkuar sqarime nga prodhuesi Viva Tech, ndërsa në përgjigje ky prodhues me dt:28.12.2016 ka konfirmuar se katalogët janë të tij dhe nuk mund të ketë asnjë veprim kundërligjor në lidhje me dyshimet e juaja.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Korporata Energjetike e Kosovës

1x1 OE “Solid Company”

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së